

VENDIM
Nr.719, datë 20.10.2011

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË
SHËRBIMEVE TË MIDHJES DHE PESHKIMIT, SARANDË**

(Ndryshuar me VKM nr. 1068, datë 14.12.2013)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkriren e Ndërmarrjes së Rritjes së Midhjes e Zënies së Peshkut, me qendër në Sarandë, e krijuar me vendimin nr.152, datë 8.4.1992 të Komitetit Ekzekutiv të rrethit Sarandë.

2. Krijimin e *Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, si institucion publik me seli në Tiranë, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave*.

3. *Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës* drejtohet nga drejtori, i cili emërohet nga *Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave*.

4. Rekrutimi i punonjësve të *Drejtorisë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës* bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Punës.

5. *Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës* ka këto detyra:

- a) Menaxhimin e Qendrës dhe Impianteve të Midhjes, në Sarandë;
- b) Menaxhimin e porteve dhe qendrave të peshkimit në të gjithë territorin e vendit;
- c) Menaxhimin e ekonomive të rasateve të peshkut, në Zvezdë, Korçë dhe të rasateve të koranit, në Lin, Pogradec;
- ç) Grumbullimin e të dhënave statistikore të prodhimit të peshkut dhe molusqeve, si dhe të të dhënave social-ekonomike.

6. *Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës* harton rregulloren e vet të funksionimit, ku përcaktohen të drejtat, detyrat dhe përshtimet e vendit të punës së çdo funksioni në këtë drejtori. Rregullorja miratohet nga *Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave*.

7. Veprimtaria e *Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës* të financohet nga buxheti i *Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave*.

8. Struktura dhe organika e kësaj drejtorie miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit të *Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave*.

9. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për ndjekjen e procedurave në QKR, për çregjistrimin si person juridik të Ndërmarrjes së Rritjes së Midhjes e Zënies së Peshkut, me qendër në Sarandë.

10. Ngarkohen *Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave* dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha